| Te tjera shfrytezimi                              | 0                                               |                                    |                    |           |                                      |                       |                                |          | 0          |                                                   |
| Totali                                            | 22,608,293                                      |                                    | 1,706,102          | 1,706,102 |                                      |                       |                                |          | 24,314,395 |                                                   |

HARTOI  
ELONA CAKONI



ADMINISTRATORI  
ASTRIT HAXHIU



**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**  
(Të gjitha balancat janë në lekë).

**1. Informacione te pergjitheshme**

"AURORA KONSTRUKSION" Sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 20.03.2000 Kapitali rregjistruar eshte 99 000 000 Leke dhe zoterohet nga ortakët themelues me keto perqindje ,z . Agron Jaupllari 40%, Valbona Jaupllari 40% , Z. Astrit Haxhiu 10 % ,Z. Sabri Keco 10 %.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2014 jane ne fushen e ndertimit te apartamenteve per banim dhe puneve publike me fonde private, Buxhetit te Shtetit, Bankes Boterore dhe Bashkimit Evropian .

**2. Permbledhje e politikave kontabel**

**Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare' dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

*Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2014 eshte zbatuar formati i SKK-2 dhe per rrjedhim zerat e pasqyrave financiare te periudhes krahasuese 2013 jane klasifikuar ne pershtatje me formatin e ri, ndryshime te cilat shpjegohen ne shenimet ne vazhdim.*

**Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:**

**Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

**Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2014 janë 1 euro=140.14 leke dhe 1 USD= 115.23.

**Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqeson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2014 eshte 15 % e ndryshme me ate qe ka qene ne ushtrimin e mëparshëm.



## Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

## Pasivet financiare

Huate e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

## Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës së vlerësimit mbetur për makineri e pajisje si dhe për tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura për amortizimin është norma e cila është brenda kufijve që lejohet nga legjislacioni fiskal.

## Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje të inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjes të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

### 1. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në bankë dhe arke, në lekë dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

| Emertimi i Llogarisë | Monedha | Gjendja në 31.12.2014 |   | Gjendja në 31.12.2013 |   |
|----------------------|---------|-----------------------|---|-----------------------|---|
|                      |         | Në lekë               |   | Në lekë               |   |
| Llogari bankare      | LEK     | 83,705,222            | - | 69,846,680            | - |
| Arka në lekë         | LEK     | 225,010               | - | 1,400                 | - |
| Shuma                |         | 83,930,232            | x | 69,848,080            | x |

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të Bankës së Shqipërisë.

### 2. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2014 deklarohen si vijon:

|                                                               | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2013 |
|---------------------------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Aktive të tjera financiare afatshkurtra                       |                                       |                                       |
| (i) Llogari / Kërkesa të arketueshme (klient)                 | 385,496,517                           | 473,714,526                           |
| (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arketueshme (Tatim fitimi) | 4,130,017                             | 1,128,567                             |
| (iii) Kërkesa të tjera të arketueshme Tvsh                    | 94,768                                |                                       |
| (iv) Të tjera kërkesa (garanci bankare)                       | 22,193,981                            | 2,184,368                             |
| Shuma                                                         | 411,915,283                           | 477,027,461                           |



Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " janë pasqyruar situacionet e ndertimit të pallateve të cilat nuk janë likuiduar nga porositesit si dhe fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Komisioni European.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne garancite bankare 31.12.2014 ne shumen 22 193 981 leke te cilat bllokohen per efekt pjesemarie ne tendera.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

### 3. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

|                               | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2013 |
|-------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| <b>Inventari</b>              |                                       |                                       |
| (i) Lëndët e para             | 3,592,620                             | 4,326,515                             |
| (ii) Prodhim në proces        | -                                     | -                                     |
| (iii) Produkte të gatshme     | -                                     | -                                     |
| (iv) Mallra për shitje        | -                                     | -                                     |
| (v) Parapagesat për furnizime | 55,908,490                            | 2,102,282                             |
| <b>Shuma</b>                  | <b>59,501,110</b>                     | <b>6,428,797</b>                      |

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2014. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e koston se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar". Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2014 eshte 733 895 leke.

Shuma e inventarit te paraqitur ne "Lende e pare" perfaqeson stokun e materialeve, te vleresuara me koston e blerjes.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes koston se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

### 3 Shpenzime te shtyra

*Krahasimisht me nje vite me pare kane ndryshuar dhe jane ne shumen 55 908 490 leke.*

### 4 Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Vlera e aksioneve dhe investimeve te tjera ne pjesemarie eshte 20 000 leke, e cila perfaqeson pjesemarjen me 20% te aksioneve ne krijimin e shoqerise koncesionare (HEC) e mbartur nga viti ushtrimor 2013.

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:



| Gjendjet dhe levizjet |                                | Toka | Ndertesa | Makineri dhe<br>pajisje | Aktivet e tjera<br>afatgjata materiale | Totali     |
|-----------------------|--------------------------------|------|----------|-------------------------|----------------------------------------|------------|
| A                     | Kosto e AAM-ve me 01.01.2014   | -    | -        | 47,755,033              | 2,675,560                              | 50,430,593 |
|                       | Shtesat                        | -    | -        | 3,579,500               | -                                      | 3,579,500  |
|                       | Pakesimet                      | -    | -        | -                       | -                                      | -          |
|                       | Kosto e AAM-ve 31.12.2014      | -    | -        | 51,334,533              | 2,675,560                              | 54,010,093 |
| B                     | Amortizimi AAM-ve 01.01.2014   | -    | -        | 21,077,620              | 1,530,673                              | 22,608,293 |
|                       | Amortizimi ushtrimit           | -    | -        | 1,522,433               | 183,669                                | 1,706,102  |
|                       | Amortizimi per daljet e AAM-ve | -    | -        | -                       | -                                      | -          |
|                       | Amortizimi i AAM-ve 31.12.2014 | -    | -        | 22,600,053              | 1,714,342                              | 24,314,395 |
| C                     | Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2014  | -    | -        | -                       | -                                      | -          |
|                       | Shtesat                        | -    | -        | -                       | -                                      | -          |
|                       | Pakesimet                      | -    | -        | -                       | -                                      | -          |
|                       | Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2014  | -    | -        | -                       | -                                      | -          |
| D                     | Vlera neto e AAM-ve 01.01.2014 | -    | -        | 26,677,413              | 1,144,887                              | 27,822,300 |
|                       | Vlera neto e AAM-ve 31.12.2014 | -    | -        | 28,734,480              | 961,218                                | 29,695,698 |

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2014. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane jo me shume se ato qe perdoren per qellime fiskale.

Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

## 5 Detyrime afatshkurtera-Huamarriet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 jane ne vleren 90 170 601 leke.

## 6 Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 paraqiten si vijon:

|                                               |                    |                    |
|-----------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Huatë dhe parapagimet                         |                    |                    |
| (i) Të pagueshme ndaj furnitorëve             | 260,775,902        | 253,935,227        |
| (ii) Të pagueshme ndaj punonjësve             | 1,666,631          | 1,004,225          |
| (iii) Detyrimet tatimore(TAP)                 | 20,330             | 46,150             |
| (iv)Te tjera detyrime të tjera(Sig shoqerore) | 518,628            | 329,998            |
| (v)Detyrime ndaj shtetit per TVSH             |                    | 961,580            |
| (vi) Tatim Fitimi                             |                    |                    |
| (vii) Parapagimet e arkëtuara                 |                    |                    |
| (vili)Kreditore te tjere                      | 10,600,000         | 921,038            |
| (x)Maredheniet me pronaret                    | 15,346,762         | 19,557,312         |
| <b>Shuma</b>                                  | <b>288,928,253</b> | <b>276,755,530</b> |

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e materialeve e sherbimeve pa u likuiduar ne fund te ushtrimit . Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me



shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor . Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Te pagueshme ndaj punonjesve" ne shumen 1 666 631 leke, "Detyrimet tatimore per sig.shoqerore" ne shumen 518 628 leke , TAP 20 330 leke , i perkasin muajit Dhjetor 2014, te gjitha keto te paguara ne Janar 2015.

"Kreditore te tjere " ne shumen 10 600 000 leke perfaqesojne shpenzime te kryera ne vitin 2014 por te mbartura per likuidim ne vitin pasardhes.

## 7 Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 jane ne vleren 0 leke.

## 8 Kapitali e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te regjistruar ne QKR mbas shtesave te bere vitet e kaluara. Me 31.12.2013 ai eshte 99 000 000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 990 000 leke /kuota. Ne drejtim te zoterimit te ketij kapitali nga ortakët nuk ka ndryshime.

## 9 Fitimi (humbja) e vitit financiar

### ▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

|                                               | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2013 |
|-----------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| <b>Te ardhurat nga shitja e produkteve</b>    | 0                                     | 0                                     |
| Te ardhurat nga kryerja e punimeve ne ndertim | 187,287,716                           | 433,060,924                           |
|                                               | 0                                     | 0                                     |
| <b>Shuma</b>                                  | <b>187,287,716</b>                    | <b>433,060,924</b>                    |

Të ardhurat nga shitja e punimeve dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme të zhveshura nga TVSH-ja . Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

Sqarojme se diferenca e shifres se afarizmit me sistemin tatimor eshte 11 988 739 leke. Kjo difference vjen si rezultat i stornimit perfundimtar te paradhenies se arketuuar nga viti 2012.

### ▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, furniturave dhe shërbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2014 jane treguar ne pasqyren perkatese.

| 2. Pasqyra e shpenzimeve per periudhen<br>01 Janar - 31 Dhjetor 2014 |                                                       |  |                      |                      |
|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|--|----------------------|----------------------|
| Nr                                                                   | Pershkrimi i elementeve                               |  | Viti 2014            | Viti 2013            |
|                                                                      | Materialet e konsumuara                               |  | (66,149,329)         | (160,147,134)        |
|                                                                      | Kosto e punes                                         |  | (18,423,035)         | (16,841,214)         |
|                                                                      | - pagat e personelit                                  |  | (15,786,663)         | (14,431,200)         |
|                                                                      | - te tjera personeli                                  |  |                      |                      |
|                                                                      | - shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore |  | (2,636,372)          | (2,410,014)          |
|                                                                      | Amortizimi dhe zhvleresimet                           |  | (1,706,101)          | (1,855,330)          |
|                                                                      | Shpenzime te tjera                                    |  | (98,212,087)         | (221,866,536)        |
|                                                                      | <b>Totali i shpenzimeve</b>                           |  | <b>(184,490,552)</b> | <b>(400,710,214)</b> |



Materialet e konsumuara ne shifren 66 149 329 leke perfaqesojne materialet e para te blera me fature me Tvsh nga furnitore vendas si dhe shumen perfundimtare 2 103 517 leke te paradhenies te mbartur qe nga viti 2012. Te gjitha keto shpenzime jane perdorur ne funksion te aktivitetit. Ne shifren e mesiperme eshte perfshire edhe diferenc e inventarit ne vleren 733 895 leke.

Shpenzimet e tjera perfaqesojne shpenzimet si me poshte:

|     |                             |                   |
|-----|-----------------------------|-------------------|
| 611 | Trajtime te pergjithshme    | 85,216,565        |
| 613 | Qira                        | 120,000           |
| 616 | Sigurime                    | 1,811,698         |
| 618 | Te tjera                    | 1,830,399         |
| 625 | Transferime, udhetim, dieta | 1,041,740         |
| 626 | Shpz.postare e telekom.     | 937,227           |
| 628 | Sherbime bankare            | 293,667           |
| 634 | Taksa dhe tarifa vendore    | 64,877            |
| 657 | Gjoha dhe demshperblime     | 6,895,914         |
|     | <b>SHUMA</b>                | <b>98,212,087</b> |

Zeri i shpenzimeve (611) perfaqeson punimet nga nenkontraktoret perfshire ketu edhe vleren e paradhenieve te faturuara e te paguara e cila mbartet nga viti 2012, dhe kap vleren 2 103 517 leke per periodhen ushtrimore 2014.

Zeri i shpenzimeve (613) Qira eshte ne vleren 120 000lek sipas kontrates se qerases per te cilen eshte paguar tatimi ne burim 10% e vleres.

Zerat 616, 618, 626 jane te gjitha shpenzime ne ndihme te aktivitetit te justifikuara me fatura me tvsh.

Llogaria 625 Transferime udhetime e dieta ne vleren 1 041 740 leke perfaqeson te gjitha shpenzimet qe jane bere per personelin ne lidhje me ndjekjen e te gjitha objekteve jashte rrethit te Tiranes, vlere kjo e justifikuar me dokumentet perkatese.

Llogaria 628 ne vleren 293 667 leke perfaqeson shpenzimet bankare per komsione bankare per periodhen ushtrimore.

Llogaria 634 taksa dhe tarifa vendore ne vleren 64 877 leke perfaqeson pagesat vjetore per Taksat e Bashkise Tirane.

Llogaria 657 ne vleren 6 895 914 leke jane kontabilizimet nga akt kontrolli tatimor si dhe shpenzime te cilat nuk i sherbejne aktivitetit kryesor te firmes.

#### ▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

|                                           | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2013 |
|-------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Te ardhurat nga interesat 767, 667 (+)    | 199,657                               | 38,159                                |
| Shpenzimet per interesat 767,668 (-)      | 0                                     | 0                                     |
| Fitimet nga kursi i kembimit 769, 669 (-) | 2,729,735                             | 23,787                                |
| Humbjet nga kursi i kembimit              | -125,694                              | -1,375,411                            |
| Te ardhura te tjera financiare            | 12,660                                |                                       |
| <b>Shuma</b>                              | <b>2,816,358</b>                      | <b>-1,313,465</b>                     |

#### ▪ Shpenzime personeli

Shoqeria ka marre ne pune dhe ka paguar punonjesit e saj konform dispozitave ligjore.Per ata jane paguar kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe jane ber ndalesat per keto kontribute si dhe per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi rregullisht.

#### Fitimi i ushtrimit dhe tatimi mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2014 dhe 2013 jane si vijon:



|     |                                               |            |            |
|-----|-----------------------------------------------|------------|------------|
| I   | FITIMI NETO PARA TATIMIT                      | 5,613,522  | 31,037,245 |
| II  | SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)                 | 6,895,914  | 2,334,882  |
| 1   | Amortizime tej normave fiskale                |            |            |
| 2   | Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor |            |            |
| 3   | Gjoha,penalite,demshperblime                  | 965,914    | 2,334,882  |
| 4   | Provizione qe nuk njihen                      | -          | -          |
| 5   | Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta         | -          | -          |
| 6   | Te tjera                                      | 5,930,000  | -          |
| III | PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)                 | -          | -          |
| IV  | FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)            | 12,509,436 | 33,372,127 |
| V   | Shpenzimi i tatim fitimit-15%                 | 1,876,415  | 3,337,213  |
| VI  | FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)                  | 3,737,107  | 27,700,032 |

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem i cili ka dale pasi i jane shtuar fitimit te ushtrimit edhe shpenzimet e pazbriteshme ne shumen 6 895 914 leke.

#### **10 Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2014 eshte ulur shifra e afarizmit.

#### **11 Shifrat krahasuese**

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2014 jane te krahasueshme me ato te pasqyrave te ushtrimit 2013 pasi jane ndertuar sipas SNK-ve.



**SHOQERIA AURORA KONSTRUKSION SH.P.K**  
**NIPT K02017003I**

**Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2014**

| Nr | Emertimi         | Sasia | Gjendje<br>01/01/2014 | Shtesa           | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2014 |
|----|------------------|-------|-----------------------|------------------|----------|-----------------------|
| 1  | Toka             |       | 0                     |                  |          | 0                     |
| 2  | Ndertime         |       | 0                     |                  |          | 0                     |
| 3  | Makineri,paisje  |       | 38,645,929            | 76,000           |          | 38,721,929            |
| 4  | Mjete transporti |       | 9,109,104             | 3,503,500        |          | 12,612,604            |
| 5  | Kompjuterike     |       | 2,675,560             |                  |          | 2,675,560             |
| 6  | Zyre             |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                  |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                  |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                  |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    | <b>TOTALI</b>    |       | <b>50,430,593</b>     | <b>3,579,500</b> | <b>0</b> | <b>54,010,093</b>     |

**Amortizimi A.A.Materiale 2014**

| Nr | Emertimi              | Sasia | Gjendje<br>01/01/2014 | Shtesa           | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2014 |
|----|-----------------------|-------|-----------------------|------------------|----------|-----------------------|
| 1  | Toka                  |       | 0                     | 0                |          | 0                     |
| 2  | Ndertime              |       | 0                     |                  |          | 0                     |
| 3  | Makineri,paisje,vegla |       | 15,990,732            | 1,291,142        |          | 17,281,874            |
| 4  | Mjete transporti      |       | 5,086,888             | 231,291          |          | 5,318,179             |
| 5  | Kompjuterike          |       | 1,530,673             | 183,669          |          | 1,714,342             |
| 6  | Zyre                  |       |                       |                  |          |                       |
|    |                       |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                       |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                       |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    | <b>TOTALI</b>         |       | <b>22,608,293</b>     | <b>1,706,102</b> | <b>0</b> | <b>24,314,395</b>     |

**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2014**

| Nr | Emertimi              | Sasia | Gjendje<br>01/01/2014 | Shtesa           | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2014 |
|----|-----------------------|-------|-----------------------|------------------|----------|-----------------------|
| 1  | Toka                  |       | 0                     |                  | 0        | 0                     |
| 2  | Ndertime              |       | 0                     |                  |          | 0                     |
| 3  | Makineri,paisje,vegla |       | 22,655,197            | -1,215,142       |          | 21,440,055            |
| 4  | Mjete transporti      |       | 4,022,216             | 3,272,209        |          | 7,294,425             |
| 5  | Kompjuterike          |       | 1,144,887             | -183,669         |          | 961,218               |
| 6  | Zyre                  |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                       |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                       |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    |                       |       | 0                     |                  |          | 0                     |
|    | <b>TOTALI</b>         |       | <b>27,822,300</b>     | <b>1,873,398</b> | <b>0</b> | <b>29,695,698</b>     |

**Administratori**

**ASTRIT HAXHIU**



FIRMA "AURORA KONSTRUKSION"Sh.p.k

PASQYRA E INVENTARIT TE MJETEVE TE TRANSPORTIT me 31.12.2014

| NR | EMERTIMI                 | NJESIA | SASIA | KAPACITETI   |              |              | TARGA   |
|----|--------------------------|--------|-------|--------------|--------------|--------------|---------|
|    |                          |        |       | Nr.i vendeve | Pesha pa ng. | Pesha me ng. |         |
| 1  | Furgon i Markes Benz     | cope   | 1     | 2+1          | 2000kg       | 3500kg       | TR3539B |
| 2  | Autoveture e Markes Benz | cope   | 1     | 4+1          | 2200kg       | 2870kg       | TR8411F |
| 3  | Kamioncine Benz          | cope   | 1     | 2+1          | 2000kg       | 3500kg       | TR0073T |
| 4  | Ekskavator Sh 970628     | cope   | 1     | 1            | 7600kg       | 7600kg       | ABMT90  |

ADMINISTRATORI

Astrit HAXHIU




FINANCIERI

Elona Cakoni



**DEKLARATE**

Deklaroj se **Shoqëria** Aurora Konstruktion Sh.p.k me **NIPT K02017003I** me Administrator Z.Astrit Haxhiu dhe **aksionere:**

1. Z. Agron Jaupllari perqindja e pjesemarrjes 40%
2. Zj. Valbona Jaupllari perqindja e pjesemarrjes 40%
3. Z. Astrit Haxhiu perqindja e pjesemarrjes 10%
4. Z. Sabri Keco perqindja e pjesemarrjes 10%

ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2014 komform standarteve kombetare te kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

**Zj Elona Cakoni (ekonomiste e punësuar pranë shoqërisë) / Aurora Konstruktion Sh.p.k**

Z/Zj. \_\_\_\_\_ (kontabël i miratuar ) me NIPT \_\_\_\_\_ /

Shoqeria \_\_\_\_\_ (studio kontabiliteti) me NIPT \_\_\_\_\_.

Per "Aurora Konstruktion" Sh.p.k

ADMINISTRATORI

  
ASTRIT HAXHIU

